



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.315, Datë 30.11.2022

PËR
“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR
PROKURORIN YLLI PJETËRNIKAJ”

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Ylli Pjetërnikaj, si personel akademik me kohë të pjesshme, për lëndën “E drejtë penale (pjesa e posaçme)” në “Albanian University” Tiranë (Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative), për periudhën kohore që përfshin semestrin e parë të vitit të parë, për vitin akademik 2022-2023.
2. Të njoftohen për këtë vendim zoti Ylli Pjetërnikaj, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 30.11.2022.

KRYETAR

Alfred Balla

